



Departamenti i Prokurimit

Prishtinë: datë, 21.08.2020

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 19.08.2020 të parashtruar nga Operatori Ekonomik "Benita Company SHPK" për aktivitetin: "Hapja e rrugeve të reja në Komunën e Prishtinës" dhe me numër të prokurimit: 616 -20-2819-521 nxjerr:

V E N D I M

Refuzohet kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekonomik "Benita Company SHPK" e datës 19.08.2020 lidhur me aktivitetin e prokurimit "Hapja e rrugeve të reja në Komunën e Prishtinës" dhe me numër të prokurimit: 616 -20-2819-521 kundër *Njoftimit për Vendimin e AK-se të datës 14.08.2020*, të publikuar në web-faqe të KRPP-së.

1. **Vertetohet Njoftimi për Vendimin e Autoritetit Kontraktues të datës 14.08.2020;**
2. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik "Benita Company SHPK" ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Hapja e rrugeve të reja në Komunën e Prishtinës" dhe me numër të prokurimit: 616 -20-2819-521.

Autoriteti Kontraktues, me datë 21.08.2020 dhe ka shqyrtuar kërkesën në fjalë dhe ka konstatuar si vijon:

Pretendimi juaj se tenderi juaj është refuzuar pa të drejtë s është i pa bazuar për faktin se në ofertën tuaj ju keni përfshirë disa të dhëna për tre anëtarë të stafit profesional: Naser Kurbogaj, Zgjim Shabani dhe Faton Bajselmani, dy të parët si inxhinier konstruktiv, ndërsa i treti inxhinier i gjeodezisë. Ua përkujtojmë se kërkesa nga FDT-ja e dosjes së tenderit ka qenë si vijon:

OE-ik duhet të ofroj dëshmi për stafin profesional dhe atë si vijon;

- Udhëheqës i punishtes - Nje Inxhinier i dip. i ndërtimtarisë – min. 3 vite përvojë pune pas diplomimit (drejtimi konstruktiv ose infrastrukturë).
 - Dy (2) Inxhinier ose baçelor te ndërtimtarisë (konstruktivi ose infrastrukture) me dy vite përvojë pune pas diplomimit
 - Një inxhinier ose baçelor i diplomuar i gjeodezisë me tri vite përvojë pune pas diplomimit.
- Nga kërkesa shihet qarte se ju eshte dashte te caktoni stafin profesional ne kete perberje:Nje inxhinier si udheheqes te punishtes,dy inxhinier tjere konstruktiv dhe nje inxhinier te gjeodezise.

Ne oferten tuaj ju do te thot se nuk keni cekur asnje anetar tjeter te stafit qe caktohet per kete projekt,ndersa nga lista e ATK-se, AK-ja nuk ka obligim as kompetence qe te percaktoj se cilet anetar te stafit tuaj duhet te menaxhojne projektin,por kjo ka qene kompetence dhe obligim i juaji qe nuk e keni kryer me rastin e pergatitjes dhe dorezimit te ofertes.

Bazuar ne sqarimet paraprake u vendos si ne Dispozitiv te Vendimit.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. **Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimi te ketij vendimi.**


Zyrtari përgjegjës i Prokurimit